

POEZIA


Bogomil Gjuzel (Maqedoni) është autori fitues i Rezidencës letrare "POETIKA – Tirana in Between 2016" për muajin qershor, rezidencë kjo e themeluar për herë të parë në Shqipëri nga POETIKA në mars të vitit 2013, e cila ka zhvilluar veprimtarinë falë bashkëpunimit me rrjetin TRADUKI, me Ministrinë e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, me Ambasadën Gjermane në Tiranë, Fondacionin kulturor të Liechtensteinit, duke u ofruar mundësi krijuese dhe bashkëpunimi 22 shkrimtarëve dhe përkthyesve letrarë europianë dhe duke sjellë përmes tyre pasurimin e jetës dhe skenës kulturore shqiptare.

Cili është Bogomil Gjuzel

Bogomil Gjuzel është poet, prozator, skenarist, eseist dhe përkthyes. Ka lindur në vitin 1939 në Shaçak të Serbisë. Në vitin 1963 diplomohet për gjuhën angleze në Universitetin e Shkupit dhe kalon një vit akademik në Universitetin e Edinburgut si bursist i British Council. Ai ka punuar si dramaturg në teatrin Dramski të Shkupit në periudhat 1966-1971 dhe 1985-1998. Ka qenë pjesëmarrës në Programin Ndërkombëtar të Shkrimtarëve në Iowa, SHBA dhe në një sërë festivalesh si ai i Roterdamit (1978 & 1996), San Francisco-s (1980), Herleen-it (1991) si dhe Mastrihit dhe Valencias (2000).

Bogomil Gjuzel është një prej themeluesve të Shoqatës së Shkrimtarëve të Pavarur të Maqedonisë dhe kryetar i parë i saj. Që prej vitit 1995 ai punoi si kryeredaktor i revistës periodike Nashe Pismo. Që prej vitit 1999 ai mbajti funksionin e drejtorit artistik të Festivalit ndërkombëtar Mbrëmjet e Poezisë, Strugë.

Botime poetike: Līvadhī (1962 & 1971), Trëndafilī alkīmīk (1963), Mbjajtēsīt e libaçonēve (1966) – laureuar me çmimin "Vëllezërit Miladinov" si libri më i mirë i vitit, Odisēa në ferr (poezi të zgjedhura, 1969), Pusi i kohēs (1972) – laureuar me çmimin "Vëllezërit Miladinov"; Rrota e vitit (1977), Realitēti është gjithçka (1980), Shtetrrëthimi



Bogomil Gjuzel

(1981), Hapēsirē boshe (1982), Errēsirē dhe qumēsht (1986) – laureuar me çmimin "Aleksa Santiaē" për periudhën 1985-88, Duke rrēzuar murin (1989), Poezi të zgjedhura (1991), Jetē e zhveshur (1994), Kaos (1998), Ajo/Atē (poemē e gjatē, 2000), Poezi të zgjedhura - 1962-2002 (2002).

Përzgjedhje në gjuhën serbe dhe kroate: Qielli, toka dhe dielli (1963), Līvadhī (1972) – botuar në dy gjuhë, Poema (1981), Përzgjedhje në gjuhën sllovene: Peshku i shqisēs (1985). Përzgjedhje në anglisht: Tre (1972), Mbet-

jet e rishqyrtuara (Chattanooga Chapbooks, Tennessee, 1997), Ujku tek porta (Xenos Books, California, USA, 2001). Që nga viti 1963 Bogomil Gjuzel, ka qenë pjesë e të gjitha antologjive për poezinë jugosllave dhe maqedonase.

Libra në prozë: Historia si njerë (Esse, 1969), E gjithë bota është shtëpi (kujtime udhëtime nga Irlanda dhe SHBA, 1975), Histori mitike (tri pjesë teatrale, 1982), Legjenda (tregime, 1984), Legjenda dhe histori të tjera (2011), si edhe Vandaku (ese – në process botimi).

Si bashkautor me Ljubisha Georgievski ka botuar E zeza (një farsë tragjike, 1989).

Një përzgjedhje e poezisë së Bogomil Gjuzel është botuar në serinë 130 autorë maqedonas (An Island on Land, 44) në gjuhën maqedonase (2009) dhe në anglisht (2011); vepra e tij e zgjedhur (Bogomil Gjuzel: Vëllimi I dhe II).

Poezitë e tij janë përfshirë në të gjitha antologjitë me poezi maqedonase dhe jugosllave, botuar që prej vitit 1965 në shumë se 20 gjuhë të huaja. Me poezinë e tij

Lech Miodynski mbrojti dhe botoi disertacionin e doktoratës: "Bogomil Guzel, Poetycki dialog z naturan I kulturan (WYDAWNICTWO Uniwersytetu Slaskiego, në Katowice 1994), përkthyer dhe botuar në gjuhën maqedonase, 1999.

Bogomil Gjuzel përzgjedhi antologjinë e poezisë bashkëkohore maqedonase publikuar në Belgjikë (në frëngjisht dhe në flemisht - Poètes Dix-Sept macedonniens (L'arbre a Paroles, 1993).

Përkthime: Bogomil Gjuzel ka përkthyer 15 vepra nga Shakespeare, mes të cilave: Makbethi (1969), Mbreti Lir (1972), Hamleti (1980), Jul Çezari (1981), Ëndrra e një nate vere (1984), Nata e Dymbëdhjetë (1985), Shtrëngata (1992), Tit Androniku (1994) etj.

Po ashtu, Bogomil Gjuzel ka përkthyer dhe përshtatur një mori veprash të tjera dramaturgjike nga anglishtja si dhe poezi të përzgjedhura nga T. S. Eliot (1965), W. H. Auden (versionin dygjuhësh - 1971 dhe edicionin e dytë në vitin 2011), Charles Simiaē (1984), Emily Dickinson (1986), Seamus Heaney (2001), Walt Whitman (në proces botimi) si veprat skenike të S. Beckett, H. Pintor, E. O'Neil, S. Sheppard, E. Bond, B. Shaw etj. Në vitin 1978 ai ka përkthyer dhe redaktuar (së bashku me Louis Simpson dhe Serge Fauchereau) një Antologji të Poezisë Bashkëkohore Amerikane (edicioni i dytë dhe i rriparë i së cilës është ribotuar më 1999)

NGA BOGOMIL GJUZEL

POETI PROFESIONIST

Fjalën e fundit, gllënjken e fundit
Dhe çohesh nga tryeza pas orarit të punës
Autobusit të shtërgarkuar i hipën deri në kuzhinë
Nduk një copë buke dhe i merr erë furnelës.
Uri dhe plumb i shkrirë nëper trup.
Ndize monitorin
prej kopshtit
Dhe shfiteo shtypin e ditës
nga qielli.

Asgjë dhe asgjë
Lastarët e pjergullës
Lekunden kot fare

Duhet të drejtohen me litare nën strehë.
Bija të sjellë karrige për të hipur.
"Tavolina gatë", - thërret gruaja
Nga dritarja e një koha tjetër.

Pas dreke, shtëllt nëper kopsht
Ti velem në skafander, yjet përreth
Dhe poshte teje. Antenat duhet të shtrëngohen
Molla e shartuar do pleh.

Persëri në studio –
"Babi ç'është ky
Perbindesh?"; Fet, komanda deshton
Copa letrash fluturojnë si të çmendura.
Mbi tavolinë –
një fletë e re
Dhe lapsi i rëndë sa revolva.

TË SOGUARIT

Mbaroi dhe një ditë.
Edhe pse nuk më shtyn njeri
Të kthehem në shtëpi
Qielli mbyllet si barku
I hapur para koha
E grilat në horizont
Lëshohen me kërcëllimë.
U mbyllt dyqani i boles.
Sonte më magnetizoi me lodhje
Dhe alkool. Një kothere buke dhe hi.

Ditën e vazhdoj me pagjumësi.

Fet, valra ndizet
Mbase ndonjë diell mesnate
Dhe unë e shoh veten si po eci
Nëper rrugicën e caktuar
Prej shkretëtirës së shuplakës sime.

Luanesha e këngës
S' do të ulët në karrigë
Dhe kërcën mbi mua
Mbrohem me karrigët e tjera
Me gjithçka që më mungon
As fishkëllima e kamxhikut
E fundit që degjoj për të
Eshhtë duartrokija

Vrapoj nëper hapësirën e çelur
Dhe meqë nuk degjova NDAL
U gjenda përballë mureve
Të lirisë sime

Nisën të më kërkojnë me reflektorë
Fet, muri u hap
Dhe unë hyra tek gruaja e panjohur
Kërcësin përreth rafalët
E reflektorët u lodhën së rrotulluari
U këputën edhe shufrat me tela gjëmbore
Dhe posa e kalova
Berrylin e rreshqitshëm të murit
Më zuri papritmas plumbi i fundit

Por para se të zhgërryhem
Pashë përtej këndit
Një geto tjetër me mur rrethuar
Mbase i gjallë
Dhe kuplova –
Rrëthimi është i plotë.

Nuk të paguhet në ndërtosh shtëpi mbi zall
Do të vijne erëra shkretëtirash
Dhe do të shpërngulin

Themele duhet të gërmosh
Në çdo kokërr rëre –
Shkretëtira, thjesht, është e pabanueshme
Poshtë shkretëtirës është deti i shterur
Trupi yt

Dhe velem aly ngrehina lëshon rrënjë

Por unë jam gurr
I hedhur nga ndërtuesit
Jetim i vejuhshës – materia e parë
Njerëzit e tjerë janë gurrë të gjallë
Që shkrihen në ndërtim
Pa plasarritje

Tanimë edhe vetë u bëra erë
Që hakëron nëper plasarritje
Oofitë edhe midis dy kokrrash rëre

ENDJE NËPËR TOKËN KARAVLASHKË

Qielli i rrezon yjet
Ngadalë si të zjasisë amshuar
Me të dashurën përditëmi
Nëper pyjet e errëta
Pa fat

Hej moj tokë Karavlashkë
E fortë je prej pikëllimi

Endrën s' e kam të paster
Do të bëhem murtajë
Murtajë e zezë Maqedoni
Erë e kuqe Veriore
Dhe erë e ëmbël Bogomile

Njerëz, më pranoni si rebel
Jo dashnor të mrekullive
Do të fluturoj me erërat
Erëra të paqena shpresoj
Nëper shkretëtirë

Hej nëper atë fushë të shkretë Karavlashkë
Këngë do këndoj
Për gratë me mëkate
Hej mor bandill i sertë.

Yjet vdesin
Gjithnjë e më tepër pakësohen
Qentë lehin nëper qiellin që rrezohet
Okenë e djegin
Hej moj tokë, tokë Karavlashkë

Fis Karavlashk, njeri Karavlashk
Fundi s'iu gjelë pikëllimit.

LAVDËRIM PËR AJRIN

Të thith dhe – nuk të shfryj
Dhe në ty mbeten të hapura zgavrat
Kruspuli mbledhen rreth grushit tim
Si rreth ndonjë planeti të shkretë
Që se shpejtli do të çelet me hapin e parë të jetës.

Në ty varre gjëmasht
Mumje eremili,
Shpërtim i murit të zërit
Të gris e të bën leckë
Dhe sarkofagu bëhet pluhur.

Nëse të dal përpara
E të përfaqoj për vdekje
Prapa meje inka e ciklonit
Me përdejç si hije.

Dëgjoj si kërcasin kockat urie
Të skeletit tënd të drobitur
Varrin e ke në kraharonim tim
Prej ku i gjallë s' do të dalësh dot.

2.
Megjithatë prej meje do dalësh
Ringjallur nga varri
Tradhtar

Me vodhe, më hëngre
Dhe me bukën e të vdekurve
Tani fryhesh si filuske.

NËNA ITAKË

Përse kështu, nëna Itakë të shtërsoshin
Me pakicë e me shumicë e të gjallë
Me gjithë qimet, thundrat dhe bishin
Me gjithë të kaluarën tëndë të kuqe
Me gjithë vezet e paplunueshme brezash
Me gjithë kiltihen e paçrënjosur në bark?

Herë-herë shqelmon me të kaltra
Për t'ua prishur shigjetën e peshores
Por ata megjithatë do të marrin masën
Do të copetojnë varur në çengel
Dhe do të klasifikojnë nëper paketa
Për nevojën e tyre dhe të të huajve

Bile do pandehin se të shiten shtrënjte
Meqë të kanë blerë
Me gjithë shpirtin që të bën aq të rëndë
(Ose me frymën tëndë të ndalur)
Derisa të shpien udhës së përdëzuar
Kah thelorja e lavdisë së tyre

Por shpirti yt, në fakt, është peshë negative
Që gjithë jetën ka luftuar kundër tokësorës
Dhe kur njëherë do të ngjitesh përjetë e glluar
(Kah vëllazëria qiellore e popujve të zhdukur)
Ahere do të kuptojnë se çfarë u ke lenë –
Peshën e tyre të trupit të vdekur.

KARAGJYZEL

1.
Oetësil
T'i zbukurojmë kuajt
Për mejdanin e qetë të bukurisë
Mejdan apo?
Unë jam mejdan.

2.
Në majë të shtizës
Lind ylli

Zemër grabitqare
Tjetër zemër s'ka
Nuk gjendet

O luftë jvësh
Që po i vjedh.

3.
Hingëllima po i shemb themelet
Qielli përmbylet

O kalë largomë që këtej
Sa ka kohë.

Përktheu nga origjinali maqedonisht
Resul Shabani